



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-51

PËR VEPRIMTARINË BOTUESE DHE LIBRIN

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (e) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001);

Me qëllim të zhvillimit të një aktiviteti modern të veprimtarisë botuese dhe për librin që do t'u mundësojë botuesve dhe shfrytëzuesve të librit mënyrën më të avancuar në botimin, ribotimin si dhe nxitjen e leximit, fitimin e dijeve dhe të informacioneve të reja,

Miraton:

LIGJIN PËR VEPRIMTARINË BOTUESE DHE LIBRIN

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1.1. Ky Ligj ka për qëllim:

1. Të përcaktojë parimet dhe normat themelore për zhvillimin e veprimtarisë botuese, të zhvillojë krijimtarinë letrare, artistike, shkencore, profesionale dhe kulturore në Kosovë.
2. Të sigurojë rolin dhe rëndësinë e botuesit në sigurimin, përhapjen dhe afirmimin e prodhimit final së bashku me faktorët e tjerë që marrin pjesë në shkrimin, hartimin, botimin e librit dhe të produkteve të përfaqëta me të.
3. Të krijojë kushte që shkrimi, botimi, ruajtja, mbrojtja, përhapja dhe promovimi i librit të shpallet veprimtari me interes kombëtar.
4. Të caktojë kushtet në të cilat duhet të zhvillohet veprimtaria botuese që libri të mund të kryejë funksionin e tij parësor në ngritjen dhe aftësimin e personalitetit njerëzor.
5. Të ndikojë në krijimin e ndërgjegjes publike për vlerën dhe funksionin e librit si faktor parësor në formimin dhe informimin e personalitetit njerëzor, në transmetimin e dijeve, në përhapjen e kulturës dhe në nxitjen e hulumtimit shkencor-kulturor.

6. Të sigurojë qasjen ndaj librit dhe të nxisë shprehinë e leximit.
7. Të garantojë qarkullimin e lirë të librit dhe të produkteve të përafërta me të, si dhe përhapjen e tyre brenda dhe jashtë territorit të Kosovës përmes të gjitha teknikave dhe teknologjive.
8. Të nxisë zhvillimin e industrisë botuese në të mirë të librit dhe të produkteve të përafërta të tij.

1.2. Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente (në tekstin e mëtejshëm: Ministria e Kulturës) propozon dhe merr masa të nevojshme për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 2 Objekti

Me këtë Ligj përcaktohen rregullat në fushën e krijimit, të prodhimit, të ruajtjes, të mbrojtjes, të përhapjes dhe të promovimit të librit dhe të produkteve të përafërta me të në territorin e Kosovës.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë Ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Me “**libër**” kuptohet tërësia unitare, e ilustruar ose jo, e botuar nën një titull në çfarëdo forme, që ka për objekt materializimin e një produkti mendor të një ose më shumë autorëve dhe që botohet një herë ose herë mbas here, në një vëllim ose në shumë vëllime.
2. Me “**produkte të përafërta me të**” (librin) përfshihen: almanakë, vjetarë, katalogë, albume filatelie, albume për ngjyrosje, albume me figura për fëmijë, repertorë me informacione numerike, repertorë alfabetikë, broshura që shpjegojnë funksionimin e aparateve me të cilat janë të lidhura, partitura të thjeshta që përhapin tekstin dhe muzikën e një kënge, fletore muzike për detyra, si dhe botime të tjera të ngjashme siç janë librat me disqe, shirita magnetikë, kasete, filma ose diapozitivë, me kushtin e dyfishtë:
 - a) që këto të përbëjnë një tërësi dhe elementet e tyre të mos jenë objekt e një shitjeje të veçantë dhe
 - b) që mbështetja dëgjimore-pamore të jetë plotësuese e librit, dhe jo e kundërta, konsiderohen si libra në vështrimin e pikës 1 të këtij neni.
3. “**Autor**” është personi fizik (personat fizikë) që krijon, realizon një vepër letrare, shkencore, artistike, tekst shkollor dhe të përafërta me to, të cilat botohen në formë libri dhe duhet t’u shënohet emri i hartuesit.
4. “**Botues**” janë botuesit privatë dhe institucionet publike me të drejtë botimi të cilët zgjedhin veprat e krijuara prej autorëve ose porosisin hartimin e tyre, porosisin përkthime veprash, apo kryejnë shërbime të tjera të nevojshme, për t’i shndërruar ato në libër, realizojnë tërë procesin e krijimit, botimit e shpërndarjes së librit.
5. “**Shpërndarës**” janë botuesit privatë dhe institucionet publike me të drejtë botimi që kryejnë blerjen dhe shitjen me shumicë të librave.

6. “**Libërshitës**” janë botuesit privatë dhe institucionet publike me të drejtë botimi që ushtrojnë veprimtarinë e shitjes së librave në mjedise tregtare.

7. “**Shtypshkrues**” janë botuesit privatë dhe institucionet publike me të drejtë botimi që ushtrojnë veprimtari prodhuese me objekt shtypshkrimi dhe që zotërojnë pajisjet industriale dhe mjetet e nevojshme për prodhimin e librave.

8. “**Përkthyes**” janë botuesit privatë dhe institucionet publike me të drejtë botimi që realizojnë përkthimin e një vepe nga një gjuhë në një gjuhë tjetër.

9. “**Artgrafistë**” janë botuesit privatë dhe institucionet publike me të drejtë botimi që ideojnë dhe realizojnë përgatitjen dhe paraqitjen tërësore grafike, disenjimin e shtypshkrimeve, formatimin për diagramimin e brendshëm dhe ilustrimin e librave.

10. **Publikimet** konsiderohen librat si dhe librat me disk gramafoni, me kasetë audiovizuale, me hartë gjeografike e shtojca të ngjashme (publikimet multimediale), broshurat, separatet, revistat, gazetatat, riprodhimet artistike, veprat muzikore të shkruara në partitura, hartat gjeografike, atlaset, globuset e të gjitha llojeve, planet urbanistike, pllakatat, katalogët, programet, kartolinat dhe fotografitë e shtypura, diapozitivat etj. si dhe pjesët e tyre përbërëse apo shoqëruese të riprodhuara në mënyrë grafike, disqet e gramafonit dhe kompakt disqet, kasetat audio dhe vizuale të regjistruara, disketat kompjuterike të regjistruara dhe veprat e tjera që riprodhohen me shtypshkrim ose në një mënyrë tjetër të ngjashme.

KREU II LIRIA E BOTIMIT DHE E QARKULLIMIT TË LIBRIT

Neni 4

Botimi dhe qarkullimi i librit ushtrohet nga botues privatë dhe institucione publike me të drejtë botimi të përcaktuar me kreun VII të këtij Ligji.

Neni 5

Me këtë Ligj garantohet, mbrohet dhe promovohet liria e botimit në gjuhët e vendit dhe gjuhët e huaja dhe të qarkullimit të librit brenda dhe jashtë territorit të Kosovës. Liria e botimit dhe e qarkullimit të librit kufizohet vetëm në bazë të një vendimi gjyqësor, në rastet kur botimi apo qarkullimi i librit kryhet në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

KREU III KËSHILLI I LIBRIT

Neni 6

6.1. Këshillin e Librit, bazuar në këtë Ligj e emëron Ministri i Kulturës dhe është organ këshillëdhënës që ka për qëllim të japë iniciativa dhe të propozojë vendime në të mirë të veprimtarisë botuese, të librit dhe të leximit të tij.

6.2. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Librit zgjat 4 vjet.

Neni 7
Përbërja e Këshillit të Librit

Këshilli i Librit përbëhet prej 11 anëtarëve:

1. Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
2. Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
3. Përfaqësuesi i Universitetit të Prishtinës;
4. Përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
5. Përfaqësuesi i autorizuar nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës;
6. Përfaqësuesi i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare;
7. Përfaqësuesi i Shoqatës së Botuesve të Kosovës;
8. Përfaqësuesi i Institutit Albanologjik;
9. Tre (3) krijues të afirmuar (sipas gjinive letrare: një poet, një prozator, një kritik letrar), sipas zgjedhjes së ministrit të Ministrisë së Kulturës.

Neni 8
Detyrat e Këshillit të Librit

8.1. Këshilli i Librit ka këto detyra:

1. Të propozojë masa për të siguruar mbështetjen e sektorëve publikë dhe privatë për të mbërritur objektivat e këtij Ligji;
2. Të propozojë planet dhe programet për promovimin e librit, nxitjen e leximit dhe zhvillimin e industrisë botuese në vend në përputhje me interesat publikë;
3. Të japë rekomandime për çështje ligjore dhe nxjerrjen e akteve nënligjore të bazuara në këtë Ligj, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me fushën e librit dhe të leximit;
4. Të propozojë forma për nxitjen e leximit dhe afirmimin e librit në të gjitha nivelet e arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit;
5. Të propozojë masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e traditës së librit në vend në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës;
6. Të mbështesë forcimin e sistemit të bibliotekave me Këshillin e Bibliotekave, si dhe ruajtjen e trashëgimisë bibliografike në përputhje me teknikat dhe teknologjitë e reja të krijuara;
7. Me subjektet e tjera të propozojë organizimin e takimeve ndërkombëtare të nevojshme për rritjen e eksportit të librit dhe të produkteve të përafërta me të prodhuara në vend, si dhe të përhapjes së librit jashtë Kosovës;
8. Të ndihmojë pjesëmarrjen e autorëve, përkthyesve, botuesve dhe libërshitesve në takime, panaire, ekspozita dhe veprimtari të tjera kombëtare e ndërkombëtare kushtuar librit dhe produkteve të përafërta me të;
9. Të organizojë së bashku me subjektet botuese konkurse për dhënien e çmimeve për vepra letrare dhe shkencore, si dhe për botime në fushat që i quan me përparësi për kulturën kombëtare;

10. Të propozojë masat për mbështetjen e botimit të veprave me vlerë të veçantë kulturore, mësimore dhe shkencore;
11. Të nxisë mbështetjen e botimit të veprave të letërsisë për fëmijë, të veprave të gjinive deficitare dhe të atyre që u drejtohen personave me paaftësi ose aftësi të kufizuara;
12. Të nxisë krijimtarinë origjinale, dhe promovimin e saj në vend e në botë;
13. Të rekomandojë prezantimin e krijimtarisë origjinale në gjuhët e huaja.

8.2. Këshilli i Librit i propozon ministrit të Ministrisë së Kulturës marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e politikave në fushën e librit.

Neni 9

Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Librit

Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Librit përcaktohet me akte nënligjore.

KREU IV

MASAT STIMULUESE PËR NXITJEN E VEPRIMTARISË BOTUESE

Neni 10

10.1. Botuesit privat dhe institucionet publike me të drejtë botimi që kanë si objekt kryesor veprimtarinë e botimit dhe të shpërndarjes së librit, autorët, përkthyesit, artgrafistët e librit e të produkteve të përafërta me të, do të gëzojnë të drejtën e lirimit nga tatimet dhe nga ngarkesat të tjera fiskale dhe doganore.

10.2. Përfituesve të këtyre masave stimuluese që një herë u janë anuluar, u janë ndërprerë të drejtat e shfrytëzimit me lëshimet e tyre, nuk u lejohet shfrytëzimi i serishëm i zhgarkesave tatimore dhe fiskale të parapara me dispozitat e paragrafit paraparak të këtij neni.

Neni 11

Importimi i librit në formë të përfunduar, të papërfunduar, i fotografive, i filmave, i regjistrimeve elektromagnetike dhe i elementeve të tjerë librorë të riprodhueshëm, sipas këtij ligji lirohen nga çdo taksë doganore.

Neni 12

Donacionet e librave, të revistave, të broshurave, të katalogëve, që u bëhen institucioneve të arsimit dhe atyre të kulturës, bibliotekave, shoqatave jofitimprurëse ose sindikatave, gëzojnë përfitimet në përputhje me Ligjin.

Neni 13

Librat e botuara në Kosovë gëzojnë tarifat postare të reduktuara.

KREU V LIBRI SHKOLLOR

Neni 14

14.1. Konceptin tekst shkollor dhe kushtet e hartimit, të lejimit dhe të botimit të teksteve shkollore, të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), të drejtat dhe detyrimet e botuesve caktohen me ligj të veçantë.

14.2. Përgatitja, redaktimi, shtypshkrimi, shpërndarja dhe shitja e teksteve e librave shkollorë të miratuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe nga Universiteti kryhet nga botuesit të cilët mbeten titullarë të të drejtave të autorit për këto vepra në përputhje me marrëveshjen e lidhur me autorët.

KREU VI TË DREJTAT DHE DETYRIMET E INSTITUCIONEVE

Neni 15

Institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe përgjegjësit e tyre iniciojnë kërkesën për botimin e librit dhe krijojnë kushte për nxitjen e leximit nëpërmjet:

1. Organizimit të veprimtarive kulturore, edukuese dhe informuese me anë të institucioneve të mësimdhënies dhe të mjeteve të komunikimit;
2. Dhënies së çmimeve për promovimin, botimin dhe përhapjen e librit dhe të leximit;
3. Sigurimit të fondeve për blerjen e librave të botuar me destinim në rrjetin kombëtar të bibliotekave ose qendrave të dokumentimit me karakter publik;
4. Organizimit të ekspozitave, panairove të librit në përputhje me aktet ligjore.

Neni 16

Për të popullarizuar, afirmuar dhe avancuar veprimtarinë botuese si dhe librin origjinal e të përkthyer të të gjitha zhanreve, organet dhe institucionet e nivelit qendror, institucionet qendrore të artit, shkencës dhe të kulturës, si dhe ato regjionale e lokale, sipas këtij ligji, janë të obliguara që çdo vit të blejnë ose dhurohen për bibliotekat dhe nevojat e tyre; ndërsa organet dhe institucionet e kulturës për bibliotekat e tyre nga pesë 5 ekzemplarë të botuar, po atë vit, të botuesve të regjistruar në Ministrinë e Kulturës.

Neni 17

17.1. Ministria e Kulturës ndihmon blerjen e librit për pasurimin e fondeve të bibliotekave publike, në përputhje me nevojat e bibliotekave.

17.2. Ministria e Arsimit ndihmon blerjen e librit për pasurimin e fondeve të bibliotekave shkollore, në përputhje me nevojat e bibliotekave.

Neni 18

Institucionet qendrore dhe lokale, nëpërmjet organeve përkatëse, në marrëveshje me Ministrinë e Kulturës dhe me propozimin e Këshillit të Librit, marrin masat e nevojshme për përhapjen dhe nxitjen e leximit në njësitë përkatëse lokale dhe qendrore.

KREU VII REGJISTRI I BOTUESVE

Neni 19

19.1. Për tu marrë me veprimtari botuese, botues privatë dhe institucione publike me të drejtë botimi paraprakisht duhet që veprimtarinë botuese ta ketë regjistruar si biznes, në Ministrinë kompetente, në përputhje me ligjin, si dhe të jetë i licencuar dhe i regjistruar në regjistrin e veçantë të Ministrisë së Kulturës.

19.2. Licencën për veprimtari botuese nga paragrafi paraprak e lëshon Komisioni i veçantë i Ministrisë së Kulturës.

19.3. Kriteret dhe kushtet për ushtrimin e veprimtarisë botuese, përcaktohen nga Ministria e Kulturës me propozim të Këshillit të Librit.

19.4. Botuesit të cilët ushtrojnë këtë aktivitet përpara hyrjes në fuqi të këtij Ligji duhet të regjistrohen dhe të licencohen në Regjistrin e Botuesve brenda një afati prej 6 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Neni 20

Rregullat për regjistrimin dhe çregjistrimin e botuesve nga Regjistri i Botuesve i përcakton Këshilli i Librit dhe i zbaton Ministria e Kulturës.

KREU VIII DËFTUESIT E LIBRIT DHE NUMRI NDËRKOMBËTAR I STANDARDIZUAR I LIBRIT (ISBN)

Neni 21

Në çdo libër të botuar në Kosovë duhet të jenë të shënuar dëftuesit e mëposhtëm:

- i. Titulli i veprës;
- ii. Emri i autorit;
- iii. Emri i përkthyesit, hartuesit, përpiluesit;
- iv. Viti i botimit;
- v. Vendi dhe emri i shtypshkronjës;
- vi. Emri i botuesit apo entit botues;
- vii. Numri ndërkombëtar i standardizimit të librit (ISBN);
- viii. Çmimi;
- ix. E drejta e autorit;
- x. Katalogimi në botim (CIP);
- xi. Dëftues të tjerë sipas specifikës së botimit, nëse ka;
- xii. Tirazhi i ekzemplarëve të botuar.

Neni 22

Rregullorja e Agjencisë së Standardizimit të Botimeve të Librit përcakton procedurat që ndjek botuesi për kërkimin, marrjen dhe aplikimin e ISBN-së.

KREU IX ÇMIMI I SHITJES SË LIBRIT

Neni 23

Çdo botues privatë dhe institucione publike me të drejtë botimi që boton, importon dhe eksporton libra, cakton çmimin e shitjes së librit, përveç botimeve shkollore për të cilat merret miratimi nga Ministria e Arsimit.

Neni 24

Çmimi i shitjes bëhet i njohur publikisht duke u shënuar në mbulesën e jashtme të librit me anë shtypjeje ose mbietiketimi. Në rast të mbietiketimit, etiketa mban edhe emrin e botuesit.

Neni 25

Çdo botues, shpërndarës, eksportues dhe importues i librit është i obliguar gjatë botimit të librit në të ta vë qartë e lexueshëm edhe çmimin e tij.

Neni 26

26.1. Për librat e vënë në shitje para daljes së këtij Ligji dhe që nuk përmbajnë të shënuar çmimin e shitjes, shënimi i çmimit të shitjes është detyrë e botuesit ose e importuesit të librit dhe e libërshitësit me autorizim të botuesit ose të importuesit.

26.2. Shënimin e zbaton libërshitësi ose rrjeti libërshitës mbështetur në dokumentimin e çmimeve përkatëse nga ana e botuesit ose e importuesit të librit.

26.3. Mbikëqyrjen dhe kontrollin përkitazi me respektimin e detyrimit nga neni 25 në pajtim me ligjin e ushtrojnë inspektorët kompetentë të tregut.

Neni 27

27.1. Ndryshimi i çmimit të shitjes bëhet nga botuesi dhe importuesi duke iu komunikuar libërshitësit dhe rrjetit libërshitës në mënyrë të dokumentuar vetëm me vendim të organit drejtues të botuesit, nëse me marrëveshje ose kontratë nuk është vepruar ndryshe.

27.2. Afati nga komunikimi i këtij ndryshimi për zbatimin e tij duhet të jetë i mjaftueshëm që libërshitësi dhe rrjeti libërshitës të mund të kryejë shënimin e ekzemplarëve në depozit. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

27.3. Libërshitësi apo shpërndarësi nuk mund të ndryshojë çmimin e shitjes së librit me konsignacion apo të produkteve të ngjashëm me të pa miratimin e botuesit.

Neni 28

Çmimi i shitjes nëpërmjet pajtimit dëftohet në dokumentet e shitjes ose katalogët nëpërmjet të cilëve bëhet porosia.

Neni 29

Për shkelje të dispozitave nga kreu IX i këtij Ligji, çdo individ i dëmtuar, subjekt juridik, shoqatë e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve, shoqatë botuesish, sindikatë e profesionistëve të botimit ose të përhapjes së librit si dhe vetë autori i librit ose çdo agjenci që mbron të drejtat e autorëve, ka të drejtë të kërkojë ndalimin e cenimit të të drejtave të tij dhe dëmshpërblim përkatës pranë organeve përkatëse.

KREU X DORËZIMI I DETYRUAR I EKZEMPLARËVE

Neni 30

30.1. Botimet në formë libri, broshure, afisheje, harte postale, harte, atlasit gjeografik, partiture muzikore dhe koreografike, pavarësisht nga mbështetja e tyre materiale dhe nga procedura teknike e prodhimit, e botimit dhe e shpërndarjes, të shtypura brenda ose jashtë territorit të vendit nga botues privatë dhe institucione publike me të drejtë botimi, që ushtrojnë aktivitet në fushën e botimit dhe të shpërndarjes në Kosovë, me t'u vënë në dispozitim të publikut përbëjnë objekt të një dorëzimi të detyruar prej pesë (5) ekzemplarësh në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

30.2. Çdo botues privatë dhe institucione publike me të drejtë botimi që boton publikime në Kosovë që i dedikohen përdorimit publik, detyrohet që pesë kopje të çdo publikimi t'ia dërgojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e botimit.

30.3. Nëse botuesi nuk është i identifikuar, nuk ka vendqëndrim ose seli në Kosovë, këtë detyrim do ta kryejë shtypshkronja, subjekti që ka bërë riprodhimin.

Neni 31

Dorëzimi kryhet sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për Bibliotekat.

Neni 32

Në rastet e prodhimeve të një libri apo të produkti të përafërt me të, në më shumë se një format apo kopertinë, i cili përmban një numër identifikimi ISBN të ndryshëm, prodhimet do të konsiderohen botime të ndryshme dhe do t'i nënshtrohen dorëzimit të detyrueshëm të ekzemplarëve.

KREU XI
DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 33

Shkeljet e dispozitave detyruese të këtij Ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

Neni 34

34.1. Konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë shkeljet e dispozitave të mëposhtme:

1. Ushtrimi i aktivitetit të botuesit pa licencim dhe regjistrim në Regjistrin e Botuesve përbën shkelje administrative dhe ndëshkohet me gjobë prej 1.000 €(një mijë euro) deri në 10.000 €(dhjetë mijë euro).
2. Kur botimi, riprodhimi i plotë apo i pjesshëm, fotokopjimi i një libri dhe i produkteve të përafërta me të, përfshirë këtu edhe përkthimin, kryhet nga subjekte të cilët nuk kanë fituar këto të drejta në bazë të një marrëveshjeje në përputhje me dispozitat e Ligjit për të Drejtat e Autorit, dhe të Drejtat e Afërta dhe ky veprim nuk përbën vepër penale në bazë të Kodit Penal, ndëshkohet me gjobë nga 1.000 (një mijë) deri 10.000 €(dhjetë mijë euro), në varësi edhe të tirazhit të tij.
3. Botimi dhe shpërndarja në treg e librave pa përmbajtur dëftuesit e librit parashikuar në këtë Ligj, ndëshkohet me gjobë të 10 (dhjetë) fishit të çmimit të shitjes së librit në publik.
4. Ndryshimi i çmimit të shitjes së librit nga libër shitësit apo shpërndarësit, pa miratimin e botuesit, dënohet me gjobë prej 500 €deri në 1.000 €
5. Shkelja e detyrimit për dorëzimin e detyruar të ekzemplarëve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në bazë të Ligjit për Bibliotekat.

34.2. Mjetet financiare të grumbulluara nga ky nen derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 35

Njësitë e qeverisjes lokale obligohen që në buxhetin vjetor të përcaktojnë fonde për blerjen e librave për bibliotekat publike.

KREU XII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 36

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji mbi Veprimtarinë Botuese (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 7/74), si dhe çdo akt tjetër në kundërshtim me këtë Ligj.

Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-51
16 mars 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha